



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 444 Prot.

Tiranë, më 18.03 2019

**VENDIM Nr. 70 datë 18.03.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike-Butrint" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr Shpresa Gjongecaj dhe Prof.Asoc. Belisa Muka (IA) si dhe Prof.Dr. Sandro de Maria (Universiteti i Bolonias-Itali), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike-Butrint" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr Shpresa Gjongecaj dhe Prof.Asoc. Belisa Muka (IA) si dhe Prof.Dr. Sandro de Maria (Universiteti i Bolonias-Itali), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

**Në Foinike**

I. Gërmime

- Sondazhe dhe kërkime në monumentin e përmasave të mëdha, në jug të agorasë helenistike (A11)
- Gërmime në pjesën lindore të kodrës (A5)

II. Restaurimi i strukturave të gërmuara dhe valorizimi i sitit

III. Survejimi i territorit

**Në Butrint**

- Vazhdimi i rilevimit topografik të mureve rrethuese me Laser Scanner dhe realizimi i planimetrive, prerjeve dhe prospekteve të integruara në shkallën 1:50;
- Rilevimi fotogrametrik 1:50 i sipërfaqeve arkitektonike;
- Dokumentim analitik – pastrim sipërfaqësor, fotografim dhe rilevim topografik të detajeve i strukturave në veri dhe jug të bazilikës së Akropolit dhe mbi Portën e Liqenit ose Porta Scea;
- Hapja e 2 e sondazheve me përmasa të kufizuara në segmentin e murit rrethues në Akropol, në kufijtë e zonave të gërmuara gjatë viteve 1982-86 dhe 1989-1994 për të verifikuar praninë eventuale të stratigrafisë, që do të ndihmonte me elementët e nevojshëm për datimin; një sondazhi tretë do të hapet pranë kullën në afërsi të Portës veriore.

2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**